

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

**30.06.2022
Ora 11:00**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj zotit Fatmir Juka, përgjegjës i Galerisë së Arteve Shkodër dhe zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|--|--|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja |
| • Parti politike | Z. M. Logu (PD) |
| • Qëndresa Qytetare | Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari |
| • Të tjerë: | |

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, atëherë në seancën e sotme kemi në rend dite: Shpalljen e vendimeve për shqyrtimet administrative të denoncimeve të organizatës Qëndresa Qytetare. E para, për rastin që lidhet me veprimtarinë e kandidatës për kryetare të Bashkisë Lushnje zonja Eriselda Sefa dhe drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile zotit Haki Çako.

E dyta, po për shpalljen e vendimit për rastin e Bashkisë Shkodër për veprimtarinë e kandidatës për kryetare bashkie nga Partia Socialiste për Bashkinë e Shkodrës si dhe drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Pika e tretë, shpallja e vendimit për shqyrtimin administrativ të denoncimit për rastin e Bashkisë Shkodër të veprimtarisë të kandidatës për kryetare bashkie zonjës Majlinda Angoni dhe drejtoreshës të Qendrës Shëndetësore “Rrethina”.

Pika e katërt, po shpallje e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, për rastin e Bashkisë Durrës për veprimtarinë e kandidatës për kryetare të Bashkisë Durrës, zonja Emirjana Sako dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin zoti Arben Ahmetaj”.


Pika e pestë, ka të bëjë “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonjës Ana Dhamo, drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej drejtore e Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtore e Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Pika e gjashtë, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj Fatmir Juka, drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër dhe Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Atëhere fillojmë...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për procedurë!

Z. I. Celibashi: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kërkoj që pika e fundit e rendit të ditës të vendoset si pikë e parë zoti Komisioner, për shkak se ne si subjekt Partia Demokratike e Shqipërisë nuk kemi interes për çështje të tjera të cilat janë ngritur nga denoncuesi Qëndresa Qytetare, por dhe për shkak të disa angazhimeve të tjera, për shkak të punës në orën 11.30, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord! Atëherë fillojmë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zotit Fatmir Juka drejtor i Galerisë së Arteve Shkodër, zotit Xhemal Bushati, kandidat për kryetar i Bashkisë Shkodër i Partisë Demokratike, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për procedurë sërish zoti Komisioner. E para, kërkoj që të administrohet prokura e posaçme me nr. protokolli 1304, nr. koleksioni 659 nga zoti Xhemal Bushati ku më autorizon mua në cilësinë e përfaqësuesit të tij. Nga ana tjetër për sa i përket përfaqësimit të Partisë Demokratike, besoj se jam i legjitimuar në këtë proces?!

Z. I. Celibashi: Po, dakord! Administrojmë prokurën e relatuar. Mirë atëherë vazhdojmë me shqyrtimin administrativ. Fjala është për përfaqësuesen e Qëndresës!

Znj. T. Kurti: Ne e kemi bërë njëherë këtë seancë por zoti Logu kërkoi administrimin...

Z. I. Celibashi: Po për t'u njohur dhe për t'u... po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Znj. T. Kurti: Kështu që besoj...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, është e vërtetë zoti Komisioner, në fakt ne kemi kërkuar të njihemi me provat që janë sjellë nga ana e Qëndresës Qytetare për të paraqitur pretendimet e tyre në vlerësimin tonë krejtësisht të pabazuar. Së pari, zoti Komisioner, ne jemi juristë dhe ka disa rregulla të mirpërcaktuara se si paraqiten provat. Provat ose duhet të jenë origjinale ose të njehsuara me origjinalin dhe në raste kur ato merren nga faqe elektronike do të duhej që minimalisht të kemi një vërtetim të dokumentit elektronik që bëhet pranë një zyre noterie. Në rastin konkret ne shohim se ka dy lidhje, një adresë të një faqe në facebook të cilën mbetet e paidentifikuar, kemi një video në youtube dhe kemi 4 foto në fakt të cilat pretendohen të vlerësohen si prova. Në vlerësimin tonë, këto prova nuk janë paraqitur në formën e kërkuar nga ligji. Pra, ato nuk janë as në formë origjinale as në formë të njehsuar me origjinalin dhe aq më pak të jetë bërë një vërtetim pranë një zyre noterie sa i përket këtyre provave. Kështu që në vlerësimin tonë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të mos administrojë këto prova pasi nuk janë paraqitur në formën e kërkuar nga ana e ligjit. I referohemi zoti Komisioner, dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, sepse vendimi nr. 9, datë 9 mars 2021 në fakt nuk ka diçka të mirpërcaktuar përsa i përket formës apo mënyrës se si duhet të merren dhe administrohen provat. Kështu që vlerësoj se duhet të referohemi te Kodi i Procedurave Administrative duke qenë se jemi në një procedurë administrative dhe kërkoj që kjo vendimmarrje të merret paraprakisht. Se nga kjo vendimmarrje juaja, ne do të procedojmë më pas në paraqitjen e pretendimeve tona në lidhje me këtë denoncim të paraqitur nga denoncuesi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*


Z. I. Celibashi: Para se t'i jap fjalën përfaqësueses së Qëndresës, argumenti juaj është që këto nuk duhet të merren si prova nga ana e Komisionerit pasi nuk janë në formën e kërkuar nga ligji dhe ju keni pretendime në lidhje me vërtetësinë e tyre si prova?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për sa kohë nuk janë në formën e kërkuar nga ligji i nderuar, ne nuk i futemi vërtetësisë së provës. Vërtetësinë e një prove apo jo, do ta shohim në momentin që ato do të ishin paraqitur në formën e kërkuar nga ligji. Meqenëse nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, ne kërkojmë që të mos administrohen në këtë proces administrativ. Jemi të detyruar të gjithë së bashku t'i parashtrohemi parimeve të ligjshmërisë. Pra, çdo veprim procedural qoftë edhe administrimi i thjeshtë i provave duhet të kryhet në përputhje me parimet e ligjshmërisë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Po përfaqësuesi i Qëndresës?

Znj. T. Kurti: Siç e tha edhe zoti Logu, Vendimi nr. 9 i Komisionit Rregullator nuk ka një formë të caktuar pasi përveçse është një reformë e re, denoncimi në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është një mjet për çdo qytetar, për çdo palë të interesuar e cila ndoshta edhe nuk ka dijeninë se si t'i bëjë këto denoncime. Kështu që provat që administrohen, janë prova që më pas administrohen nga procesi hetimor dhe i takon organit të gjykojë vërtetësinë e tyre. Po ashtu nëse do t'i referohemi noterizimeve dhe elementëve të tjerë, do të shtonte edhe barrën ekonomike për palët, kështu që kjo është forma e vetme që një qytetar, organizatë mund t'i administrojë provat. Zoti Logu nuk i paska parë me aq vëmendje, sepse nëse klikon në atë links që ai citoi, ato të çojnë automatikisht te faqet zyrtare, tek elementë që vërtetësia e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

tyre provohet lehtësisht. Kështu që ne, kërkojmë rrëzimin e pretendimit të palës dhe kërkojmë pranimin e administrimit të këtyre provave ashtu siç është bërë në çdo denoncim tjetër.

Z. I. Celibashi: Faleminderit!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Jo është e rëndësishme në fakt se kanë dy elementë shumë të rëndësishëm. E para, padijenja e ligjit nuk të justifikon, fakti që ti mund ta dish ose jo si paraqiten provat në një proces administrativ, kjo mendoj unë që është e tejkaluar tashmë. Pra, fakti që ti nuk njeh ligjin nuk të justifikon që ti të bësh veprime që bien në kundërshtim me ligjin. Ligji ka parashikuar se si paraqiten provat në një proces administrativ. Së dyti, zoti Komisioner është shumë e rëndësishme, barrën e provës kush e ka në këtë proces? Unë mendoj se e ka denoncuesi, pra denoncuesi na ka sjellë para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve pasi pretendon se janë kryer shkelje. Do të duhej që këto shkelje të provohen me prova të sjella në mënyrën e kërkuar nga ligji. Nga ana tjetër, ne mendojmë që nuk është argument ligjor fakti që sjellja e provave në formën e kërkuar nga ligji shton barrën ekonomike. Kjo është një çështje që çdo denoncues kur bën një denoncim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e merr përsipër diçka të tillë se me këtë qëllim po themi dhe kur shkon në gjykatë dhe paraqet një padi, ajo ka një kosto të caktuar. Ti e merr përsipër që në momentin që mendon të investosh gjykatën. Kështu që, për të gjitha ato argumenta e përsëris, provat nuk janë në formën e kërkuar nga ligji, ne duhet t'i nënshtrohemi parimit të ligjshmërisë duke mos i administruar këto prova në këtë proces administrativ.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Z. I. Celibashi: Dakord, vlerësoj që ato prova janë të paraqitura në përputhje me parashikimet e ligjit, tej vlerësimit mbi to, mbi provueshmërinë nëpërmjet tyre të fakteve dhe pretendimeve, kjo ngelet një çështje tjetër. Por, në pikëpamje formale mendoj që jemi brenda kritereve të ligjit, qoftë dhe Kodit të Procedurës Administrative, për mënyrën se si paraqiten provat. Kështu që ngelet në konsiderim administrimi dhe vlerësimi i tyre. Kemi gjë tjetër para se ta përfundojmë, ndonjë kërkesë tjetër?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne do të parashtrijmë qëndrimin tonë, sepse fakti që ne kishim pikëpyetje, apo paqartësi, apo kishim pretendimet tona mbi çështjen e provave, kështu që nëse me lejohet do të kaloja në fazën e paraqitjes së pretendimeve tona sa i përket denoncimit të kryer nga denoncuesi.

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë gjë tjetër?


Znj. T. Kurti: Ne e shohim si të pavënd edhe njëherë administrimin apo jo të provave që është bërë dhe njëherë tjetër në një seancë dëgjimore...

Z. I. Celibashi: E mbyllëm këtë kapitull. Atëherë, para se t'i japim fund hetimit administrativ, përfaqësuesi i Qëndresës pastaj përfaqësuesi i Partisë Demokratike dhe i kandidatit për kryetar bashkie i Partisë Demokratike për zgjedhjet e Bashkisë Shkodër.

Znj. T. Kurti: Përsa kemi parashtruar përgjatë gjithë këtij procesi hetimor dhe në seancën e parë dëgjimore, ne bazuar në provat dhe faktet që kemi sjellë, por bazuar dhe në përgjigjet e ardhura nga drejtori i Galerisë së Arteve, kërkojmë konstatimin

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

e shkeljeve nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 171, 172 dhe nenin 10 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator ndaj drejtorit të Galerisë së Arteve zotit Fatmir Juka dhe ndaj subjektit zgjedhor Partia Demokratike dhe kandidatit zotit Xhemal Bushati.

Z. I. Celibashi: Po, zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner! Kam pyetje në fakt se mund të na shërbejë për të na ndriçuar të gjithëve denoncuesi. Pyetja e parë, a ka zhvilluar Qëndresa Qytetare disa aktivitete që lidheshin me paraqitjen e platformave nga ne kandidatëve të partive politike në zgjedhjet e 6 marsit? Të lutem përgjigjet të jenë të shkurtra se edhe pyetjet janë të shkurtra.

Z. R. Xhemollari: Po!


Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: A janë ftuar 3 kandidatët për kryetarë bashkie në Bashkinë Shkodër për të marrë pjesë në këtë aktivitet?

Z. R. Xhemollari: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Cilët kandidatë i janë përgjigjur pozitivisht kësaj ftese?

Z. R. Xhemollari: Xhemal Bushati dhe kandidati Bardh Spahia.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pra, zoti Bushati ka marrë pjesë në një aktivitet të zhvilluar nga ana juaj apo nuk ka marrë pjesë?

Z. R. Xhemollari: Po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ka marrë pjesë! Ka pasur ndonjë denoncim nga ana juaj për zotin Bardh Spahia lidhur me zgjedhjet e zhvilluara në datën 6 mars në Bashkinë Shkodër?

Z. R. Xhemollari: Po, ka pasur.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në çfarë faze ndodhet ky denoncim nëse mund ta di?


Z. R. Xhemollari: Nuk është në asnjë fazë për momentin.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pyetje tjetër, ju pretendoni që ka shkelje nga ana e zotit Fatmir Juka, neni 6 pika 3 të vendimit nr. 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator? Si e provoni që aktiviteti është zhvilluar gjatë orarit të punës?

Znj. T. Kurti: Në vijim të procesit hetimor kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ju keni ngritur një denoncim, keni thënë që gjatë orarit zyrtar të punës nuk lejohen etj., etj. dhe zoti Juka ka sjellë përgjigjen e tij në një moment të dytë. Në momentin e parë ju si keni arritur në konstatimin që aktiviteti është zhvilluar gjatë orarit zyrtar të punës?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*


Znj. T. Kurti: Ky ishte konstatimi ynë, prandaj është gjithë ky proces hetimor, gjithë kjo seancë dëgjimore për të provuar rast pas rasti konstatimet tona. Zoti Juka e pranon vetë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në faqen e parë të denoncimit që keni paraqitur nga ana juaj, ju pretendoni që zoti Juka ka shkelur nenin 91 të Kodit Zgjedhor ku keni cituar në fakt edhe nenin 3 pika 1.1 germa “c” të vendimit nr. 9 të datës 24.12.2020. Pyetja ime për ju është kjo, mesa lexoj unë te neni 3 germa “c” thuhet “Në zbatim të këtij vendimi veprimtaria e ndaluar etj., etj., janë ato veprimtari që kanë të bëjnë me mbështetjen dhe promovimin e projekteve ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor, si dhe të objekteve publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore”. Ky aktivitet që ju supozoni, ka pasur qëllim të mbështesë, të promovojë një projekt apo një investim?

Z. I. Celibashi: Të gjitha këto pyetje i kanë thënë ata në denoncimin e tyre. Pyetjet bëhen me qëllim për të sqaruar provat e paraqitura ose për të sqaruar rrethana ose për të marrë informacion. Ata i kanë dhënë interpretimet e tyre, kanë bërë vlerësimet e tyre dhe i kanë dhënë argumentat e tyre. Nuk do të shkojmë asgjëkundi me këtë seri pyetjesh, e kam fjalën.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Komisioner me respekt, por unë besoj se pyetjet e mia e kanë një qëllim të caktuar, i cili do të kuptohet në momentin që ne do paraqesim qëndrimin tonë. Të jeni i bindur që unë kam ardhur i përgatitur në këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

proces. Pyetjet nuk janë të rastësishme e as nuk kanë qëllim që t'i humbasim kohë asnjërës prej palëve.

Z. I. Celibashi: Në vlerësimin tim, jeni duke bërë pyetje të cilat kanë të bëjnë me interpretime. I kanë dhënë ato interpretime. Nëse do të keni nevojë dakord! Nëse do të ishin pyetje thjesht edhe për ekonomi të shqyrtimit administrativ që kanë të bëjnë me marrjen e informacioneve shtesë apo kërkimin e provave shtesë... Nëse insistoni, për mua nuk ka asnjë lloj problemi, mbetet në vlerësimin e përfaqësuesve të Qëndresës për t'u përgjigjur ose jo.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Fa;eminderit zoti Komisioner nuk ka nevojë, nuk besoj se janë të nevojshme. Në fakt denoncuesi ka ngritur 3 pretendime kryesore. Së pari, denoncuesi pretendon që Galeria e Arteve e qytetit të Shkodrës i ka vënë në dispozicion kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Demokratike një aset publik, pasuri të paluajtshme edhe këtë pretendim e mbështet te neni 91 të Kodit Zgjedhor. Së pari, unë mendoj se është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë ka nënkuptuar legjislatori me “vënie në dispozicion”? Sepse, nëqoftëse papritmas një kandidat shfaqet në zyrë publike qoftë edhe për të aplikuar për të marrë një shërbim, një dokument apo produkt nuk mendoj që këtu jemi në “vënie në dispozicion” të një aseti publik. Cili është rasti? Pra, vënia në dispozicion i një aseti publik? Unë mendoj që ka kuptimin që t'i lejohet kandidatit që brenda një institucioni shtetëror të zhvillojë një veprimtari të caktuar politike. Të cilat mund të jenë një takim, një diskutim, realizim i një spoti elektorale. Pra, duhet të jenë aktivitete të tilla të cilat qartazi duken veprimtari politike në shërbim të fushatës së kandidatit. A jemi përpara këtij rasti? Unë mendoj se nuk jemi, sepse është thënë qartazi edhe po të doni të interferojmë shkresën e sjellë nga ana e drejtorit të Galerisë së Arteve që është një

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

vizitë e paplanifikuar, e panjoftuar dhe kjo shpjegon më pas edhe arsyen. Se ka dhe një pretendim tjetër... drejtori i Galerisë së Arteve zoti Juka, ka kryer plotësisht funksionet e tij që i takojnë sipas ligjit dhe akteve nënligjore duke pritur, informuar dhe përcjellë zotin Bushati në cilësinë e tij si qytetar. Nëqoftëse zoti Bushati do të kishte njoftuar Galerinë e Arteve që unë do të paraqitem si kandidat i Partisë Demokratike për të shpалosur vizionin tim për artin dhe kulturën në qytetin e Shkodrës kjo është një çështje tjetër. Në qoftë se zoti Juka do t'i thoshte "Po zoti Bushati ejani ju dhe përdoreni" etj., etj. Zoti Bushati nga ana e tij është paraqitur dhe ka zhvilluar një vizitë normale në Galerinë e Arteve, është larguar qetësisht në punën e tij dhe në aktivitetet e tij elektorale. Pra, nuk kemi të bëjmë me vënie në dispozicion të aseteve publike, kur vizita në fakt është e rastësishme, është e paprogramuar e planifikuar dhe nuk zhvillohen veprimtari të karakterit thelbësisht elektorale ose zgjedhor. Në këtë kuptim po themi çdo veprimtari që një kandidat politik mund të zhvillojë në një institucion mund të konsiderohet elektorale. Pra, fakti që një kandidat paraqitet në një zyrë të gjendjes civile dhe merr një certifikatë mund të fillojë të interpretohet si një lloj veprimtarie elektorale për të treguar kandidati sa mirë funksionon shërbimi i gjendjes civile. Këtu pastaj do të ishte një interpretim arbitrar dhe abuziv të ligjit. Unë mendoj që pretendimi i parë nuk qëndron përse i përket vënies në dispozicion. Së dyti, pretendimi tjetër që ka të bëjë më zotin Juka ka të bëjë me faktin që i ndalohet pjesëmarrja në veprimtari politike. Sigurisht në një veprimtari politike e cila është njoftuar si e tillë është planifikuar si e tillë ka karakter të tillë, i ndalohet pjesëmarrja. Por, ajo që zoti Juka ka shpjeguar me të drejtë, do të ishte mirë që ai të ishte dhe prezent, kishte të bënte me një vizitë të konsideruar nga ana e tij si e një qytetari dhe as nuk ka shprehur mbështetje, as favorizim, as një lloj simpatie ndaj zotit Bushati si kandidat apo platformës së tij, por thjesht ka përmbushur detyrat e tij. Ju jeni funksionarë publikë zoti Komisioner dhe ju e dini

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

që nëqoftëse në institucionin tuaj do të paraqitet dikush që nevoja e ndjen që ju duhet ta shoqëroni në institucion për ta informuar rreth veprimtarisë tuaj dhe më pas për ta përcjellë. Kjo sigurisht nuk do të konsiderohej as nga ana juaj si një shkelje ligji?! Tjetër gjë do të ishte nëqoftëse nga ana e drejtuesit të institucionit publik do të angazhohej ai në mesazhe, fjalim apo ligjërime që tregojnë njëfarë lloj mbështetje për kandidatin e partisë politike të caktuar, gjë që nuk ka ndodhur dhe s'ka se si të ndodhë sepse zoti Fatmir Juka është një emërim i Partisë Socialiste. Emërim i pastër i Partisë Socialiste, nuk ka se si të ndodhë që një njeri i emëruar nga Partia Socialiste, mbështet kandidatin e Partisë Demokratike, në logjikë të gjësë. Po të ndodhte kjo gjë, me siguri do ta shikonit zotin Juka të shkarkuar nga puna dhe ndoshta në ndonjë proces administrativ tashmë. Së treti, është përmendur mosraportimi i këtij aktiviteti. Flasim për raportim, duhet të kemi parasysh që neni 92 e ka përcaktuar qartë se cilat janë veprimtaritë që duhet të raportohen dhe thotë “Institucionet publike qendrore dhe vendore si dhe agjencitë ose ndërmarrjet shtetërore janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve”. Pra, veprimtari me karakter publik që planifikojnë ato të zhvillojnë. Pretendimi i denoncuesit është që zoti Fatmir Juka, apo institucioni i tij kishte planifikuar të zhvillonte një veprimtari me karakter publik i cili duhet të jetë i hapur për median dhe publikun, ku të ftonte qytetarët të vinin të shikonin vizitën e zotit Bushati në Galerinë e Arteve. Jo, nuk është vizitë e planifikuar e as ka pasur karakter publik. Në kohën që zoti Bushati ka qenë në institucion, qytetarë të tjerë mund të vinin për ta vizituar Galerinë e Arteve por, jo se kjo do të lidhej me veprimtarinë apo me atë vizitën që ka zhvilluar vetë zoti Bushati. Nuk ka se si të jetë detyrim për raportim, se po të ishte detyrim për raportim duhet të kishte një veprimtari publike që institucioni ka planifikuar të zhvillojë në një periudhë të caktuar kohore, në rastin e dispozitës 4 muaj përpara

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

13




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

datës së zgjedhjeve. Në rastin e zgjedhjeve të 6 marsit me afat të posaçëm sipas vendimit nr. 2 të vitit 2022 të Komisionit Rregullator. Pra, është e qartë zoti Komisioner, që s’kemi as vënie në dispozicion, as pjesëmarrje, as vënie në dispozicion të institucionit..., se po themi pastaj vetëm po të aludonim, duhet të kemi pjesëmarrje në veprimtari politike të funksionarit shtetëror dhe as detyrim në fakt për të raportuar. Por, çështja më interesante këtu është çështja e vendosjes së sanksioneve, ç’ka për mendimin tim është një fantazi ligjore e denjë për një serial komik, por jo për një proces serioz siç është ai që zhvillohet në këtë institucion. Pra, është kërkuar vendosja e sanksioneve administrative sipas nenit 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10 të vendimit nr. 9/2020. Më lejoni zoti Komisioner të ndalemi pak te neni 172, i cili thotë “subjektet zgjedhore kryejnë kundravajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore pas marrjes dijëni, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes”. Dy kushte, e para subjekti zgjedhor kryen kundravajtje kur është kryer një shkelje në favor të saj, pretendimi ynë është që nuk qëndron. Por, edhe sikur ta marrim që qëndron, do të duhej që subjekti zgjedhor të marrë dijëni për shkeljen dhe të mos marrë asnjë masë për ndalimin e saj. Rezulton që Partia Demokratike.. se dua që të sqaroj dhe një gjë se është kërkuar dënimi i zotit Bushati sipas po këtij neni. Në fakt denoncuesi duhet ta dijë që subjekt zgjedhor konsiderohet partia politike, jo kandidati. Sipas nenit 63, të Kodit Zgjedhor “Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilat paraqesin listë kandidatësh sipas rregullave që përcakton ky kod”. Pra, subjekt zgjedhor mund të jetë vetëm partia politike. Pra, subjekt quhet Partia Demokratike në këtë rast dhe duhet të plotësojë dy kushte. I pari, në favor të saj të jetë kryer ndalimi sipas Kodit Zgjedhor dhe kushti i dytë që pas marrjes dijëni, nuk merr masa. Nuk rezulton që Partia Demokratike si subjekt zgjedhor të ketë marrë dijëni për ndonjë shkelje dhe

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

të mos ketë marrë masat sipas atyre që përcaktohen në ligj. I vetmi rast zoti Komisioner, kur kandidati në fakt, konsiderohet subjekt zgjedhor është rasti kur kandidati propozohet si kandidat për deputet apo kryetar të bashkisë nga një grup zgjedhësish, që nuk është rasti i zotit Bushati. Zoti Bushati nuk është subjekt zgjedhor, sepse nuk është propozuar nga një grup zgjedhësish, por ka ardhur nga një parti politike. Pra, baza ligjore për sanksionimin e Partisë Demokratike sipas nenit 172 nuk qëndron se nuk përmbushen kushtet e diktuar nga ligji. Baza ligjore për sanksionimin e zotit Bushati nuk qëndron, sepse zoti Bushati nuk është subjekt zgjedhor, por është kandidati i një subjekti zgjedhor. Na është referuar dhe neni 10 i vendimit nr. 9 të datës 24 dhjetor të vitit 2020. Neni 10 thotë ekzaktësisht këtë gjë dhe ju ftoj ju së bashku me mua të kuptojmë nëse këtu ka ndonjë detyrim për partinë politike, apo për subjektin zgjedhor. Thotë “në rast kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë pavarësisht ndalimit të bërë nga KQZ, shkelja kur nuk përbën vepër penale dënohet me gjobë.., etj., etj”. Pra, edhe po të shkojmë te neni 4, pika 4 do të shohim që kjo dispozitë, neni 10 nuk ka të bëjë as me subjektin zgjedhor, as me kandidatin, por me titullarët e institucionit që kanë detyrimin për raportim. Pra, baza ligjore mbi të cilat kërkohet të sanksionohet Partia Demokratike e Shqipërisë si subjekt zgjedhor dhe kandidati për kryetarin e Bashkisë Shkodër, në fakt janë baza ligjore të cilat nuk përmbushin kushtet dhe kriteret që ndaj këtyre subjekteve të merren masa apo sanksione administrative. Pra, jo vetëm pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë, por denoncuesi ka një problem të rëndë të theksuar përse i përket njohjes së bazës ligjore në të cilën e mbështet kërkesën e tij. Një denoncues që ngatërron se kush është subjekti zgjedhor kandidati, apo partia politike, mendoj se ka nevojë të lexojë më me vëmendje legjislacionin e aplikueshëm në këtë rast. Për të gjitha këto arsye, ne kërkojmë rrëzimin e këtij denoncimi të bërë

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

nga ana e denoncuesit si një denoncim i pambështetur, i pabazuar në ligj dhe prova, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, përfaqësuesit e Qëndresës?

Znj. T. Kurti: Nëse mundemi me një fjali që dhe zoti Logu të jetë i qartë, sepse denoncimin tonë ndoshta as nuk e ka lexuar.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: T'i tërhiqet vëmendja denoncuesit i nderuar Komisioner, për këtë që sapo tha! Unë e kam lexuar në fakt denoncimin dhe t'i kursej vetes këtë përballje se mund të hyjmë edhe në ballafaqim individual.

Znj. T. Kurti: Edhe njëherë të mbështes pretendimin tonë, shkurtimisht dhe qartësisht. Në referim të denoncimit tonë dhe aktivitetit, gjendemi përpara një veprimtarie publike pasi në këtë aktivitet ka qenë prezente media Start+ Tv, një media lokale e qytetit të Shkodrës. Së dyti, gjendemi përpara një veprimtarie të ndaluar sepse zoti Bushati brenda Galerisë së Arteve ka shpalosur projektin e tij ku thotë se “unë kam një projekt për të zbatuar, që kurrë nuk e gjeti vullnetin. Kam kërkuar si ish kryetar i këshillit, ta kthejme godinën e Këshillit të Qarkut Shkodër në një muze...”. Gjë që po t'i referohemi nenit 3, pika “c” të vendimit të Komisionit Rregullator është shprehimisht “promovim i projekteve të ardhshme”. Po ashtu në referim të nenit 91 është vënë në dispozicion dhe është përdorur nga kandidati një aset publik i cili zoti Juka kishte detyrimin që ia dikton ligji, që të distancohej menjëherë nga ai aktivitet elektorale me karakter publik dhe politik dhe të ndalonte aktivitetin. Për sa parashtrova më sipër, ne kërkojmë konstatimin e këtyre shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Z. R. Xhemollari: Komisioner, kisha dhe diçka të fundit nëse mundem!

Z. I. Celibashi: Po!


Z. R. Xhemollari: Së pari, zoti Logu, ndoshta është ngatërruar pak me çështjen e subjektit politik pasi kur flasim për një kandidat që tashmë i ka ikur dhe subjekti është vetëm kandidati. Së dyti, kur erdhëm sot në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve na priti një vajzë poshtë, nuk na priti zoti Celibashi. Kështu që nuk ka lidhje drejtori i galerisë të presë e të përcjellë njerëzit që hyjnë e dalin në Galerinë e Arteve. Ne vlerësojmë që rastësisht nuk mundet që drejtori i galerisë, kandidati, media të bëhen bashkë dhe pastaj të bëhet një kronikë. Të mos e ndalojë askush këtë kronikë, t'u shpërndahet të gjithë qytetarëve të Shkodrës ku kandidati thotë “ne do ta kthejmë sallën e këshillit në galeri..., etj.”. Bëhen pra premtime që u shpërndahen qytetarëve dhe kjo është ajo ç'ka ne kemi konstatuar, pra shkelja. Ne nuk interpretojmë se kujt i shkon benefiti i kësaj shkeljeje, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, i japim fund hetimit administrativ. Fjala e fundit për përfaqësuesin e Qëndresës pastaj për përfaqësuesin e Partisë Demokratike.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për procedurë, kërkojmë pesë ditë kohë për paraqitjen e konkluzioneve tona përfundimtare.

Z. I. Celibashi: Dakord! Qëndresa besoj është gati për t'i paraqitur!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Znj. T. Kurti: Ne si prej fillimit të denoncimit kërkojmë edhe një herë konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative në referim të nenit 171, 172 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 10 të vendimit të Komisionit Rregullator.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit. Atëherë seanca shtyhet për t'i dhënë kohë përfaqësuesit të kandidatit të Partisë Demokratike për të paraqitur pretendimet e fundit në lidhje me këtë denoncim. Do t'ju njoftojmë për datën dhe orën e seancës së ardhshme.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

30.06.2022
Ora 11:35

RENDI I DITËS


Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj zotit Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonjës Ana Dhamo, drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej drejtore e Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtore e Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- KQZ
- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi
- 2. Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja
- Qëndresa Qytetare Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari
- Të tjerë:

Z. I. Celibashi: Atëherë vazhdojmë edhe me pikën tjetër të rendit të ditës pastaj do të vazhdojmë me shpalljen e vendimeve. Pika tjetër ka të bëjë me shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare, ndaj Edison Memolla kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, zotit Denis Dedej, përgjegjësit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zonjës Ana Dhamo, drejtore e Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, zotit Luan Shehi drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

Rrogozhinë, zonjës Margarita Dedej, drejtor i Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zonjës Mimoza Bidaj, drejtore e Kopështit Rrogozhinës. Atëherë kemi shtyrë seancën nga hera e shkuar pasi u kërkua një zgjerim objekti dhe i personave të cilët përfshihen në këtë denoncim. Asnjë nga palët e tjera nuk është prezent. Vazhdojmë seancën, palët janë të njoftuara! Prova të tjera përfaqësuese e Qëndresës? Nuk kemi për të paraqitur, atëherë i japim fund hetimit administrativ. Fjala e fundit për përfaqësuesen e Qëndresës.

Znj. T. Kurti: Përsa i përket denoncimit tonë gjithashtu edhe kërkesës për shtim objekti që u pranua. Ne kërkojmë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve marrjen e sanksioneve administrative bazuar në nenin 171, 172 dhe nenit 10 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, ndaj subjekteve Partia Socialiste e Shqipërisë dhe kandidatit zotit Edison Memolla, Partia Demokratike dhe kandidatit zotit Ferdinand Saraçi, Koalicioni Zgjedhor “Shtëpia e Lirisë” dhe kandidatit zotit Hekuran Xhani si dhe përgjegjësit për administrimin e Qendrës Kulturore.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! E mbyllim shqyrtimin administrativ në lidhje me këtë denoncim dhe kalojmë për shpalljen e vendimit të cilin do ta shpallim një ditë tjetër në një seancë tjetër publike e cila do t’ju njoftohet palëve.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

30.06.2022
Ora 11:37

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj zonjës Eriselda Sefa, kandidate për kryetar të Bashkisë Lushnjë, zotit Haki Çako Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Stafi KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja |
| • Qëndresa Qytetare | Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari |
| • Të tjerë: | |

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me shpalljet e vendimeve në lidhje me denoncimin kundrejt kandidates për kryetare të Bashkië Lushnje Eriselda Sefa, zotit Haki Çako drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Në vlerësimin tonë jemi përpara shkeljeve administrative të përmendura dhe në denoncim vetëm në rastin e kandidates për kryetare bashkie zonjës Eriselda Sefa. Për kërë rast do t'i propozohet Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e masave

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

administrative. Për sa i përket veprimtarisë së drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ne nuk vlerësojmë se jemi përpara shkeljeve administrative sikurse i përcakton Kodi Zgjedhor apo dhe akti i Rregullatorit.

Vendimi nr. 180

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

30.06.2022
Ora 11:40

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të organizatës “Qëndresa Qytetare” ndaj zonjës Emiriana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, zotit Arben Ahmetaj, ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|---------------------------------------|---------------------------------|
| 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z. Ilirjan Celibashi |
| 2. Staf i KQZ: | Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja |
| • Qëndresa Qytetare | Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari |
| • Të tjerë: | |

Z. I. Celibashi: Për sa i përket shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Emirjana Sako, kandidate për kryetare të Bashkisë Durrës, zotit Arben Ahmetaj, ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, ne vlerësojmë që në aktivitetin e kësaj date nuk jemi përpara shkeljeve administrative të Kodit Zgjedhor, pasi veprimtaria e tyre konsiderohet në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Nga ana e Ministrit të Shtetit është bërë raportimi në lidhje me aktivitetin që do të kryejë dhe nëse nuk do të ishte kjo, atëherë mund të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.30.06.2022*

ishte rasti i vendosjes së sanksionit administrativ. Konsiderohet që aktiviteti tij është në përputhje me detyrën e tij funksionale. Këto janë vendimet, faleminderit!

Vendimi nr. 183

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



30.06.2022
Ora 11:39

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”
ndaj zonjës Edona Tafa drejtor dhe mjek i Qendrës Shëndetësore “Rrethinat”,
Ambulanca Dobrac dhe zonjës Majlinda Angoni kandidatit për kryetar të Bashksë
Shkodër propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për
zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”.*

PJESËMARRJA :


• **KQZ**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- **Qëndresa Qytetare** **Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari**
- **Të tjerë:**

Z. I. Celibashi: Për sa i përket denoncimit ndaj zonjës Majlinda Angoni dhe drejtoreshës së Qendrës Shëndetësore “Rrethina” zonjës Edona Tafa, ne vlerësojmë se jemi përpara shkeljeve administrative si nga ana e kandidatës për kryetare bashkie ashtu edhe për drejtoreshën zonjën Edona Tafa. Për këtë arsye do t’i propozojmë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve vendosjen e sanksioneve administrative.

Vendimi nr. 182

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



30.06.2022
Ora 11:38

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”
ndaj zotit Haki Çako Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes
Civile dhe zonjës Majlinda Angoni kandidat për Kryetar Bashkie Shkodër, e
propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë për zgjedhjet e
pjeshme për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022”.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
- 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
- 2. Staf i KQZ:
• Qëndresa Qytetare **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja**
- Të tjerë: **Znj. T. Kurti, Z. R. Xhemollari**

Z. I. Celibashi: Për sa i përket shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës Qëndresa Qytetare ndaj zonjës Majlinda Angoni, kandidate për kryetare të Bashkisë Shkodër, zotit Haki Çako, drejtor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile si dhe subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Në përfundim të këtij shqyrtimi administrativ, ne vlerësojmë se nuk jemi përpara shkeljeve administrative për këtë rast për zonjën Angoni, ashtu si për drejtorin e agjencisë. Për sqarim për rastin e zonjës Angoni, në kohën kur është kryer ky aktivitet ajo nuk ka qenë akoma kandidate, nuk e kishte statusin e kandidates për kryetare bashkie.

Vendimi nr. 181

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

